



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 128, Datë 30 / 11 / 2017

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 86, datë 03.08.2017, të bërë nga Sh.Y¹, kundër Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat (ZVRPP), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Racës”².

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga Sh.Y, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se jeton në një shtëpi 1+1 të blerë me kontratë të rregullt në vitin 1998 nga ish pronari i shtëpisë. Është paraqitur pranë ZVRPP Berat por rezulton se shtëpia është në emër të ish pronarit. Nga ZVRPP Berat është informuar, se duhet të paguaj 300.000 lekë të cilat ankuesi për shkak të gjendjes financiare nuk i disponon, pasi familja e tij përbëhet nga 4 persona të cilët jetojnë me 3000 lekë përkrahje në muaj. Ankuesi kërkon që të shikohet mundësia për zgjidhjen e problemit të tij.

Diskriminimi për shkak të racës është një nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën.

¹ Ankesa është administruar në kuadër të aktivitetit “Ditë të hapura” me komunitetin rom, organizuar nga KMD.

² Ankuesi i përket komunitetit rom.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 789/1, datë 23.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e ZVRPP Berat, lidhur me ankesën e bërë nga Sh.Y.

Me shkresën Nr. 5979/1, datë 05.10.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të administruar tek Komisioneri me nr. 789/4 prot, datë 13.10.2017, ZVRPP Berat informon se: “Pas verifikimit në ZVRPP Berat rezulton se Sh.Y nuk ka paraqitur kërkesë zyrtarisht në lidhje me pretendimet e tij. Pas shqyrtimit të shkresës, konstatohet se nuk është specifikuar numri i pasurisë dhe numri i zonës kadastrale në të cilën ndodhet pasuria, për të bërë të mundur verifikimin e të dhënave të cilat administrohen nga ZVRPP Berat. Për sa më sipër dhe duke konsideruar se qytetari pretendon se është diskriminuar, ZVRPP Berat shfaq gatishmërinë për shqyrtimin e rastit dhe njofton Sh.Y që të paraqitet pranë institucionit për ta informuar specifikisht dhe për ta sqaruar në mënyrë të qartë”.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr.137, datë 06.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit në ZVRPP Berat”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë ZVRPP Berat, më datë 11.10.2017, për të marrë informacionin e kërkuar me shkresën nr. 789/1, datë 23.08.2017.

Gjatë inspektimit, R.P me detyrë Drejtor i ZVRPP Berat, dorëzoi një kopje të shkresës përgjigje nr. 5979/1, datë 05.10.2017, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe informoi se: “Në lidhje me ankesën e bërë, ju informojmë se pagesa e tarifës për regjistrimin e pasurisë është detyrim ligjor, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e

pasurisë së paluajtshme” dhe zyra Berat nuk ka mundësi për të bërë reduktim të masës së kësaj pagese”.

Nga verifikimi i sistemit elektronik (ALBSREP) të përpunimit të kërkesave të aplikantëve për shërbim të ZVRPP Berat, rezultoi se Sh.Y nuk kishte aplikuar për shërbim.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Ligji nr.33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij rregullojnë dhe përcaktojnë kushtet dhe procedurat për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Në nenin 38/2 të këtij ligji përcaktohet se: *“Çdo person, mbajtës i titullit të pronësisë apo i një të drejte reale nëpërmjet një akti ku këto të drejta përmbahen, duhet të paraqesë një kërkesë për regjistrimin e aktit brenda 30 ditëve nga koha e realizimit të tij”.* Gjithashtu në nenin 39 përcaktohet se: *“Nëse një kërkesë për regjistrim, sipas nenit 38 të këtij ligji, paraqitet më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, paguhet kamatvonesë, e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300.000 lekë”.*

Bazuar në përgjigjen shkresore të dërguar nga ZVRPP Berat³ dhe verifikimit të kryer nëpërmjet inspektimit të kryer në datë 11.10.2017 nuk rezulton të ketë diskriminim nga ana e ZVRPP, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk ka aplikuar për të kërkuar regjistrimin e pasurisë dhe tarifata e vendosura për kryerjen e shërbimit janë një detyrim ligjor dhe nuk janë në kompetencë të zyrave vendore për heqjen apo reduktimin e këtyre tarifave.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a dhe c/, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të racës, ndaj Sh.Y, nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, Berat.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, se nëse kërkon të regjistrojë pasurinë, të paraqitet pranë ZVRPP Berat për tu interesuar dhe për të plotësuar dokumentacionin përkatës.

³ Shkresa Nr. 5979/1, datë 05.10.2017 dhe Procesverbali i inspektimit datë 11.10.2017.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI